

Informacion për kujdestarët.

Kërkesa për regjistrim në klasa muzike, për kujdestarë nxënësish të klasave të dyta

Klasat e muzikës janë organizuar për nxënës të cilëve u pëlqen muzika dhe plotësojnë kriteret për të studiuar muzikë. Mësimi i muzikës nis në klasën e tretë dhe vazhdon përgjatë gjithë arsimit bazë edhe nëse ndryshohet shkolla. Në shkollat e arsimit gjithëpërfshirës, mësimi i muzikës vazhdon në të njëjtën shkollë përgjatë gjithë arsimit bazë. Mësimi i muzikës sjell fryte e kënaqësi por kërkon edhe ngulmim e vazhdimësi.

Për klasat e muzikës, sigurohet kohë shtesë për studimin e muzikës.

Nëse nxënësi duhet të shkojë në shkollë tjetër për klasën e muzikës, prindi apo kujdestari është zakonisht përgjegjës për shpenzimet e udhëtimit të vajtje-ardhjes nga shkolla. Megjithatë, nxënësi ka të drejtë të pajiset me një kartë udhëtimi falas nëse largësia nga shkolla është më e madhe se 5 km, si për në shkollën lokale ashtu edhe për shkollën ku ndjek klasën muzikore.

Në qytetin Vantaa, ka tetë shkolla që ofrojnë klasë muzikore.

Tikkurila-Hakunila

- Lehtikuusen koulu 3.–9.
- Peltolan koulu 7.–9.
- Simonkallionkoulu 3.–6.

Korso-Koivukylä

- Mikkolan koulu 3.–9.

Myyrmäki

- Hämeenkylässä koulu 3.–9.
- Martinlaakson koulu 3.–9.

Kivistö-Aviapolis

- Aurinkokiven koulu 3.–9.
- Ylästön koulu 3.–9.

Regjistrohu për një klasë muzike nëpërmjet shërbimit WILMA

Nxënësit do të përzgjidhen në bazë të provimit të muzikalitetit. Të gjithë ata që bëjnë kërkesë do t'i nënshtrohen një provimi. Regjistrimi për testin bëhet nëpërmjet shërbimit Wilma në periudhën 21 nëntor - 9 dhjetor brenda orës 4 pasdite. Formulari i kërkesës gjendet në Wilma ku shkruhet Hakemukset ja päätökset (Kërkesa dhe vendime) në seksionin Tee uusi hakemus (Bëj një kërkesë të re) > Ilmoittautuminen musiikkiluokkatestiin (Regjistrohu për një provim për klasë muzike).

Formulari i kërkesës mund të tërhiqet e printohet në linkun <https://www.vantaa.fi/musiikkiluokat> dhe t'i dërgohet shkollës për të cilën është bërë kërkesa.

Drejtuesit e shkollave që ofrojnë klasa me drejtim muzikor do të vendosin cilët nxënës do të pranohen në klasën e muzikës brenda datës 10 shkurt 2023. Rezultatet do të shpallen në Wilma.

Dëshironi të jeni të pranishëm në një orë klase muzike?

Kujdestarët dhe nxënësit janë të mirëpritur të marrin pjesë në një orë muzike. Duhet të bini dakord për vizitën me drejtuesin e shkollës ku zhvillohet ora e muzikës si dhe me mësuesin e lëndës, të cilët do të mund t'ju japin edhe të tjera informacione.

REGJISTROHU NË INSTITUTIN E MUZIKËS SË VANTAA-S

Instituti i muzikës së Vantaa-s (VMO) është një institucion arsimor i mirëmbajtur nga qyteti i Vantaa, i cili ofron cilësi të lartë arsimit bazë artistik në muzikë të udhëhequr nga mësues profesionistë. Është pjesë e studimeve mësimdhënien e instrumenteve, bërjen e përbashkët të muzikës dhe materialet e vizualizimit të muzikës. Mësimi zhvillohet në kolegjin e muzikës në zyrat nëpër Vantaa. Mësimi i muzikës jepet kundrejt një pagese.

Të gjithë studentët në Vantaa që aspirojnë për një klasë muzike mund të aplikojnë veçmas në formularin e aplikimit gjithashtu për t'u bërë student në Instituti i muzikës së Vantaa. Një vend studentor po aplikohet për 1-30 Prill 2024 në vmo.eepos.fi. Ne përpiqemi të ofrojmë një vend studentor për të gjithë aplikantët. Informacioni mbi përzgjedhjen e studentëve do t'u dërgohet të gjithë aplikantëve deri më 19 qershor 2024. Më shumë informacion www.vmo.fi

Gjeni instrumentin tuaj - Ndhmoni me zgjedhjen e instrumentit
Gjeni instrumentin tuaj! Në ngjarjet Soiva Talo më 4.4. dhe 6.4.2024 mësues të kolegjit muzikor Vantaa ju udhëzojnë në testimin e instrumenteve të ndryshme dhe zgjedhjen e instrumentit tuaj. Informacion mbi vendndodhjen dhe orarin www.vmo.fi